



Republika e Kosovës * Republic of Kosova
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 06.09.2024

NR.09/ 7515 /2024

KONTRATË PËR SHËRBIME

Numri i kontratës¹: 659-24-7083-2-2-1/C559 & KKHE-24-034-2-2-1

KOMUNA HANI I ELEZIT (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), Përfqesaur nga Xhevdet Bushi si Shef i Zyres se Prokurimit në njërin anë; dhe

N T Euro Turs SH.P.K., Rr.Pavarësia nr. Gorancë, HANI I ELEZIT, 811991927, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), Përfqesuar nga Ardit Berisha në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Transporti ditorë i nxënëseve sipas LOT-eve me numër identifikues: 659-24-7083-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Transporti ditorë i nxenesve të SHFMU. Ilaz Thaçi, SHFMU. Veli Ballazhi, shkolla profesionale Kacanik-sipas llojeve

No.	Lot
2	LOT 2 - Transporti Rezhanca, Gorance, Lac, Hani i Elezit dhe anasjelltas në vlerë prej 8,505.00 €
3	LOT 3 - Hani i Elezit - Kacanik dhe anasjelltas ne vlerë prej 6,966.00 €
4	LOT 4 - Transporti sipas nevojës neper Kosove ne vlerë prej 4,761.50 €

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 20,232.50 €; [Njëzetë mijë e dyqindë e tridhjetë e dy euro/50 cent] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka bërë Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues KOMUNA HANI I ELEZIT

Emri:	Xhevdet BUSHI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	06.09.2024
Vula:	

Për Ofruesin e Shërbimeve N T Euro Turs SH.P.K.

Emri:	Ardit BERISHA
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	06.09.2024
Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-24-7083-2-2-1/C559

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënime kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Neni	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 06.09.2024
	6.4	Data e Përfundimit është 04.08.2025
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është [Vendi i kryerjes së shërbimeve është Sipas relacioneve të theksuara në paramas dhe parallogari] Llot -2 Rezhançë- Gorancë dhe anasjelltas- Fsh. Laç- Hani i Elezit , "SHFMU.I.Thaçi" dhe anasjelltas Llot-3 Hani i Elezit –Kaçanik dhe anasjelltas Llot-4 –Sipas nevojave të DKA-dhe shkollave neper qytete te ndryshme te Kosovës-per aktivite te ndryshme jasht shkollore- sipas relacioneve tek pershkrimi i sherbimeve]
Obbligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është <u>Sedar Derjani-Sheji</u> i sektorit per Arsim. Per çdo shkollë nga DKA- do te cakohet nje person pergjegjes per te mbyqyrur realizimin e shërbimit te transportit te nxenesve.
Dëmet e likuiduara	13.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% në ditë për shërbime të përealizuara / në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është: 10% e vleres se kontrates me afat prej 12 muaj apo 1 vit
Gjendja e mjeteve motorike		Mjetet e transportit duhet te jene ne gjendje te rregullt tenike,dhe gido gje qe mund te ndodh me fajin e OE-se realizuese te shërbimit te transportit bie nen pergjegjesin e tij sipas ligjeve ne fuqi.
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: <i>Pagesa do te behet pas realizimit te shërbimit ne cilesi dhe sasi i pramueshme per AK-respektivisht menaxheri i kontrates dhe mbyqyrsi i shkolles perkatse per realizimi te shërbimit, dhe pas pranim te fatures se nga OE- Pagesa do te behet brenda afati ligjor, Ne raste specifike kur ka problem me buxhet të ndar per kete shërbim –pagesa do te behet sapo mjetet te sigurohen-alokohen. Pagesa do te behet sipas ditëve te shërbimit mujor te transportit te nxenesve – konform kalendarit shkollore te miratur nga MASHTI-t</i>
Kontrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <i>AK respektivisht menaxherinin e kontrates do te kontrollojnë cilesin e realizimit te shërbimit te transportit te nxënësve dhe per kete do te harton raport mujor i realizimit te shërbimit ne menyre qe te realizohet edhe pagesa per kete shërbim</i> <i>Transporti duhet te realizohet sipas rregullave per transport-Ligjit per qarkullim rrugor te mjeteve te transportit,mjeti i transportit te jete ne gjendje te rregullt teknik dhe i gatshme per qarkullim rrugor,i paisje me leje te qarkullimit te vlefshem.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Me marreveshje ne mes te AK dhe OE, ose Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë ose Ne te kunderten do te pasoj padia ne Gjykatën kompetente (do te llogariten te gjitha demet)</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Komerciale ne Prishtine b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **130434**

Për **KOMUNA HANI I ELEZIT**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **N T Euro Turs SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Transporti ditorë i nxënësve sipas LOT-eve; Lëndët e prokurimit , LOT 2 - Transporti Rezhance, Gorance, Lac, Hani I Elezit dhe anasjelltas, LOT 3 - Hani I Elezit - Kacanik dhe anasjelltas, LOT 4 - Transporti sipas nevojës neper Kosove**
Nr. prokurimit: 659-24-7083-2-2-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **2,023.25€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **2,023.25€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 365 ditë kalendarike prej **06.09.2024** deri më **06.09.2025**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përmbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 06.09.2024

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.